



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:054400

Datë: 18.10.2019

Numri i dokumentit: 00587655

P.nr.782/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Bute Ramosaj – sekretare juridike pranë kësaj Gjykate, në çështjen penale kundër të akuzuarit E.A. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me numër PP/II.nr.1386/2018, të datës 31.10.2018, në seancën publike të shqyrtimit fillestar të mbajtur, **me datën 15.10.2019**, në prezencën e Prokurores të Shtetit Dëshire Jusaj, mbrojtësit të viktimave A.P., si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 18.10.2019 e përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

E.A., nga i ati F., e ëma Sh., e gjinisë K., data e lindjes..., në Gjakovë, ku edhe tani banon, i martuar, babë i një (1) fëmijëve, nuk ka të kryer ka shkollim, mirëpo din shkrim edhe lexim, i gjendjes së dobët ekonomike, ashkali- shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datën 16.09.2018, rreth orës 18:00/h, në Gjakovë saktësisht në shtëpinë e tyre te përbashkët, me dashje e përdor forcën ndaj te dëmtuarës S.B. e cila ishte shtatzënë-viktimë e ndjeshme ne atë mënyrë, që për shkak mosmarrëveshjeve paraprake mes tyre lidhur me fëmijën e tyre te cilin i akuzuari në vazhdimësi e thërriste “Kopil” edhe në praninë e mysafirëve që ishin prezent gjatë festimit të ditëlindjes të dëmtuarës e cila e irrituar refuzon për të ngrënë tortën, të cilën e kishte porositur i akuzuari, i cili i revoltuar pasi mbylli derën e dhomës e sulmon të dëmtuarën duke e goditur me shuplaka fytyrës dhe në pjesët e tjera të trupit.

Me këto veprime ka kryer veprën të sulmit nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 55, 69, 70, 79 dhe nenit 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarit ia shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) muajve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen veprë tjetër penale. Në rast të revokimit të dënimit me kusht, në dënimin me burgim duhet të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data 16.09.2018 deri me datë 08.10.2019.

URDHËROHET Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë, që të mbikëqyrë dhe ta ekzekutojë Dënimin me Kusht, ashtu që **Obligohet** i akuzuari E.A. që të mbajë kontaktin me Shërbimin Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

E dëmtuara S.(V.)B. nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

I akuzuari E.A., lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i përgjithshëm, pranë kësaj Gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1386/2018, të datës 31.10.2018, kundër të akuzuarit E.A. nga Gjakova, për shkak të veprës penale të sulmit nëni 187 par.3 të KPRK-së. Gjatë shqyrtimit fillestar Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, ka bërë rikualifikimin e kualifikimit juridik të veprës penale nga neni 187 par.3 të KPRK-së (Kodi i vjetër) në veprën penale të sulmit nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së (Kodi i ri), duke deklaruar se me hyrje në fuqi të Kodit të ri vepra penale e sulmit është veprë penale më e favorshme për të akuzuarin me neni 184 par.3 nënpar.3.1 të KPRK-së, andaj duke marrë për bazë edhe nenin 3 par.2 të KPRK-së për zbatimin e ligjit me të favorshëm e bëjë edhe rikualifikim e veprës penale. Prokurorja e shtetit, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës kundër të akuzuarit, andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari E.A., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet, se është penduar për këtë veprim dhe gjykatës i ka premtuar se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtilla, duke shtuar se të dëmtuarën e kam bashkëshorte nuk kemi asgjë të keqe jemi pajtuar vazhdojmë të jetojmë së bashku me fëmijët.

Prokurorja e shtetit Dëshire Jusaj, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit pasi që i njëjti pranimin e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë, i ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, pranimi i fajësisë mbështetet edhe në provat dhe faktet të cilat janë bashkangjitur akuzës.

Mbrojtësi i viktimave A.P., duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtoi pranimin e fajësisë, pasi që e dëmtuara

paraprakisht edhe më ka njoftuar se i akuzuari ka kërkuar falje dhe se është zotuar para saj se nuk do e përsëris një veprë të tillë dhe se do të jetë i kujdesshëm ndaj saj dhe se familjes. Sa i përket kërkesës pasurore juridike nuk kërkon meqenëse edhe të njëjtit jetojnë përmes ndihmës sociale.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi është vërtetuar se i akuzuari E.A., me datën 16.09.2018, rreth orës 18:00/h, në Gjakovë saktësisht në shtëpinë e tyre të përbashkët, me dashje e përdor forcën ndaj të dëmtuarës S.B. e cila ishte shtatzënë-viktimë e ndjeshme në atë mënyrë, që për shkak mosmarrëveshjeve paraprake mes tyre lidhur me fëmijën e tyre të cilin i akuzuari në vazhdimësi e thërriste “Kopil” edhe në praninë e mysafirëve që ishin prezent gjatë festimit të ditëlindjes të dëmtuarës e cila e irrituar refuzon për të ngrënë tortën, të cilën e kishte porositur i akuzuari, i cili i revoltuar pasi mbylli derën e dhomës e sulmon të dëmtuarën duke e goditur me shuplaka fytyrës dhe në pjesët e tjera të trupit.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të sulmit nga neni 184 par.3 nënpar.3.1 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është baba i një fëmije, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike-përfitues i ndihmës sociale, gjykim ka pas qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra penale, faktin se me të dëmtuarën janë pajtuar, vazhdojnë të jetojnë së bashku si dhe faktin që i akuzuari më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 41 dhe 50 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimin për mbikëqyrjen dhe ekzekutimin e dënimit me kusht është marrë konform nenit 58 të KPRK-së, duke urdhëruar që dënimin me kusht ta mbikëqyr dhe ta ekzekutojë Shërbimi Sprovues i Kosovës në Gjakovë, nga se gjykata konsideron se integrimi i të dënuarit

në shoqëri ose përmbushja e dënimit me kusht të shqiptuar nga gjykata arrihet më së miri përmes mbikëqyrjes nga ana e Shërbimit Sprovues të Kosovës në Gjakovë.

Vendimi mbi udhëzimin e palës të dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi lirimimin nga shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarin është marrë konform nenit 453 par.4 të KPP-së, për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohet gjendja materiale e të akuzuarit pasi që është e gjendjes së dobët ekonomike-përfitues i ndihmës sociale ku edhe gjatë shqyrtimit fillestar i akuzuari gjykatës si ka prezantuar edhe kartelën për mes të cilës vërtetohet se i njëjti është përfitues i ndihmës sociale nga Qendra për Punë Sociale në Gjakovë.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, komfor nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.782/18, me datë 15.10.2019

Procesmbajtësja,
Bute Ramosaj

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.